# DËSHMI ARKIVI

**A-446663**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Jean Smart bën histori në Emmy, fiton për të pestin vit radhazi çmimin Aktorja Kryesore më e Mirë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/15/jean-smart-ben-histori-ne-emmy-fiton-per-te-pestin-vit-radhazi-cmimin-aktorja-kryesore-me-e-mire/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 16:11:22 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 16:06:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 16:05:00 UTC → 15 shtator 2026, 16:07:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a6dd36654c3d5cad06d89851c7bd12bded1729c3c4adf913a459ff6b31f13b0f` |
| TEKSTI | `d9f37c1e7a54890adf831bc2e87b00fde9db503a5633bfe3191fefb50e5bc0bf` |
| PAMJA | `b828e11fd153593c51cbe97f24e28205d82093b4cebe986ae29b224f1da252be` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9ec687827963ee9e20545cabd610e3d0cefe276e4024b62c79a0b89ec3a4053c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9ec687827963ee9e20545cabd610e3d0cefe276e4024b62c79a0b89ec3a4053c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Jean Smart bën histori në Emmy, fiton për të pestin vit radhazi çmimin Aktorja Kryesore më e Mirë

15/09/2026 18:06



**Jean Smart bëri histori në ceremoninë e çmimeve Emmy 2026, duke fituar për të pestin vit radhazi çmimin për Aktoren Kryesore më të Mirë në një Serial Komedi, për interpretimin e saj si Deborah Vance në sezonin e pestë të "Hacks" të HBO Max.**

Me këtë fitore, aktorja 75-vjeçare u bë e para që arrin të fitojë një çmim Emmy për çdo sezon të një seriali. Në të njëjtën kategori ishin nominuar edhe Lisa Kudrow, Quinta Brunson, Elle Fanning dhe Ayo Edebiri.

Smart u prit me një duartrokitje në këmbë nga publiku. Ajo u ngrit në skenë pasi Zendaya, e cila i dorëzoi çmimin, shpalli emrin e saj.

Duke marrë statujën në duar, aktorja bëri shaka me publikun: Vetëm burrat mund të qëndrojnë në këmbë. Vajzat mund të ulen.

Fituesja ia dedikoi çmimin e saj të ri krijuesve të "Hacks", Lucia Aniello, Jen Statsky dhe Paul G. Downs, duke vlerësuar kontributin e tyre në suksesin e serialit.

"Gjithçka fillon dhe mbaron me ta. Ju dua shumë. Çfarë udhëtimi i mrekullueshëm ka qenë", tha Smart gjatë fjalimit të saj.

Jean Smart është aktorja e dytë që fiton një Emmy për çdo sezon të një seriali. Para saj, këtë arritje e kishte realizuar vetëm Bill Cosby, i cili fitoi çmimin për secilin nga tre sezonet e "I Spy", nga viti 1966 deri në vitin 1968.

Përveç pesë çmimeve Emmy për "Hacks", Smart ka fituar edhe për paraqitjet e saj si aktore e ftuar në "Frasier" në vitet 2000 dhe 2001, si dhe çmimin për Aktoren më të Mirë Mbështetëse për "Samantha Who?" në vitin 2008.

Ajo është nominuar gjithashtu për interpretimet e saj në serialet "The District", "24", "Harry's Law", "Fargo", "Watchmen" dhe "Mare of Easttown".

Në tapetin blu të Teatrit Peacock, Smart u shfaq e shoqëruar nga djali i saj më i vogël. Aktorja kishte zgjedhur një fustan maksi të zi, me një dekolte të thellë në formë V-je dhe mëngë metalike ngjyrë argjendi me detaje të palosura.

Ajo e kompletoi pamjen me vathë vintage me diamant dhe perla, si dhe një unazë diamanti 8 karatësh.

**Top Channel**

## Pop News »

POP NEWS • TË FUNDIT



"Pengu për dy fëmijët që nuk erdhën kurrë", Soni Malaj rrëqeth me rrëfimin e saj në Grida Duma Podcast



S'e Luan Topi/ "E ëma e qëlloi me gur për ta vrarë", Pastor Vilajeti rrëfen historinë e fëmijës që shpëtoi, përlotet në studio



Një dietologe tregon si të hani karbohidratet, proteinat, yndyrnat dhe fibrat për të kontrolluar sheqerin



Video/ Pamje emocionuese, prezantuesja e Top Channel zbulon sekretin e ëmbël, në pritje të fëmijës së parë

ME TË LEXUARAT

FOTO/ Zendaya, Selena Gomez dhe yjet e Hollywood-it shkëlqejnë në tapetin blu të Emmy Awards

Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

Michael J. Fox emocionon Emmy 2026, pritet me ovacione: Pranimi i Parkinsonit nuk do të thotë t'i dorëzohesh

Jean Smart bën histori në Emmy,



Michael J. Fox emocionon Emmy 2026, pritet me ovacione: Pranimi i Parkinsonit nuk do të thotë t'i dorëzohesh

15/09 18:00



FOTO/ Zendaya, Selena Gomez dhe yjet e Hollywood-it shkëlqejnë në tapetin blu të Emmy Awards

15/09 08:15



Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

15/09 08:10



Harry dhe Meghan tërheqin fëmijët nga shkolla britanike pas vetëm dy ditësh, shqetësime për sigurinë

14/09 22:14



Tom Holland bëhet aktori me fitimet më të larta në histori, kalon Zoe Saldana dhe Scarlett Johansson

14/09 18:32



"Rikthehet" Albana Osmani: Kujtimet në Top Channel dhe sfidat e jetës së saj

14/09 17:20

## Na ndiqni:

Top Channel | TCH Pop News | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Parakalim i gabuar në superstradën Lezhë-Shkodër, disa të plagosur pas aksidentit



Top Channel/ "Paga e një magjistari…", gafa e deputetes së PS: Lapsus ishte, mos e bëni të madhe



Top News – Del nga burgu neonazisti/ Numri dy i Agimit të Artë kërkon sërish pushtet



Top News – 'Protestat, mesazh për qeverinë'/Ambasadori kroat: E drejta e qytetarëve të ngrihen



Top News – 'Tirana, përsëri pa kokë'. Rama: Gjykatat eksperimentojnë me 1 mln banorë të Tiranës



Top Channel/ Zjarr i madh në fshatin Andon Poçi, rrezikohen banesat dhe fabrika e ujit

fiton për të pestin vit radhazi çmimin Aktorja Kryesore më e Mirë

Harry dhe Meghan tërheqin fëmijët nga shkolla britanike pas vetëm dy ditësh, shqetësime për sigurinë

Tom Holland bëhet aktori me fitimet më të larta në histori, kalon Zoe Saldana dhe Scarlett Johansson

"Rikthehet" Albana Osmani: Kujtimet në Top Channel dhe sfidat e jetës së saj

"Odisea" thyen rekordin e Universal/ Filmi i Christopher Nolan bëhet më i suksesshmi në historinë e studios së njohur

Një pilulë mund t'i ketë marrë jetën Hayden Panettiere? Zbardhen detaje tronditëse nga vdekja e aktores së njohur, dyshohet se...

"Seven Up!" i jep lamtumirën kamerës pas 62 vitesh, fëmijët që u filmuan në moshën 7-vjeçare festojnë 70-vjetorin



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.